



○ Grupi për Qasje në Zgjedhje
○ Grupa za Pristup Izborima.
○ Election Access Group

DORACAQ PËR QASJEN DHE TERMINOLOGJINË E DREJTË PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

GRUPI PËR QASJE NË ZGJEDHJE
2016

Doracak për Qasjen dhe Terminologjinë e Drejtë për Personat me Aftësi të Kufizuar



○ Grupi për Qasje në Zgjedhje
○ Grupa za Pristup Izborima.
Election Access Group

Të drejtat e autorit ©2016 Grupi për Qasje në Zgjedhje.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky doracak është përgatitur nga Grupi për Qasje në Zgjedhje, i mbështetur nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) dhe financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij doracaku është përgjegjësi e vetme e Grupit për Qasje në Zgjedhje (GQZ) dhe nuk mund të konsiderohet pasqyrim i qëndrimeve të IFES dhe USAID.

Deklaratë e lejes: Asnjë pjesë e këtij dokumenti nuk mund të riprodhohet në asnjë formë me çfarëdo mjeti, elektronik apo mekanik, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin, apo nga një sistem tjetër për ruajtjen e informacionit dhe rikthimin e tij pa lejen me shkrim nga GQZ.

Përmbajtja

NJOFTIM ME GRUPIN PËR QASJE NË ZGJEDHJE	5
1. AFTËSIA E KUFIZUAR DHE QASJET E DREJTA	6
1.1 DEFINICIONI I AFTËSISË SË KUFIZUAR SIPAS LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS DHE KONVENTËS NDËRKOMBËTARE	6
1.2 MODELET E QASJEVE QË I REFEROHEN AFTËSISË SË KUFIZUARA	7
2. TERMINOLOGJIA DHE FJALËFORMIMI I DUHUR GJATË REFERIMIT DHE KOMUNIKIMIT ME PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA	9
2.1 NJOHURI TË PËRGJITHSHME DHE FJALËFORMIMI I DUHUR GJATË REFERIMIT TË AFTËSIVE TË KUFIZUARA DHE PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	9
2.2 TERMINOLOGJIA E DUHUR PËR AFTËSITË E KUFIZUARA	11
3. PARAGJYKIMET PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA	14
3.1 PARAGJYKIMET E SHPESHTA NDAJ PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	14
3.2 PARAGJYKIMET MBI PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË SHOQËRINË KOSOVARE	16
PËRMBYLLJE	20
REFERENCAT	23



- Grupi për Qasje në Zgjedhje
- Grupa za Pristup Izborima.
- Election Access Group

NJOFTIM ME GRUPIN PËR QASJE NË ZGJEDHJE

Grupi për Qasje në Zgjedhje (GQZ) është grup punues me shumë hisedarë qëllimi i të cilit është pjesëmarrja e plotë e personave me aftësi të kufizuara në proceset zgjedhore dhe në jetën publike. Grupi përbëhet nga përfaqësuesit e organizatave që përfaqësojnë katër lloje të aftësive të kufizuara (z. Afrim Maliqi, HandiKOS, znj. Rukije Gashi, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve, z. Daut Tishuki, Shoqata e të Verbërve të Kosovës, dhe znj. Sebahate Beqiri, Shoqata Down Syndrome Kosova), dy anëtarë të Kuvendit të Kosovës (znj. Ganimete Musliu dhe z. Salih Morina), tre përfaqësues të Komisionit Qendror Zgjedhor të Kosovës (z. Florian Dushi, z. Adnan Rrustemi, dhe

z. Nexhmedin Hyseni), një përfaqësuese e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (znj. Valbona Millaku), dhe dy përfaqësues nga institucionet shtetërore (znj. Luljeta Kabashi, Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë, dhe z. Qazim Gashi, Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale). GQZ kryesohet nga z. Afrim Maliqi, dhe nga dy nën-kryesues, znj. Ganimete Musliu dhe z. Florian Dushi. Përveq USAID dhe IFES, GQZ përkrahët edhe nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI).

Ky udhëzues ka për qëllim të njoftoj publikun e gjerë, përmes mediave, rreth terminologjisë dhe qasjes së duhur për personat me aftësi të kufizuara. Grupi mirëpret kontributin e të gjithë hisedarëve në përpjekjet e tij për të promovuar qasje për personat me aftësi të kufizuara në procese zgjedhore dhe në jetën publike.

1 AFTËSIA E KUFIZUAR DHE QASJET E DREJTA

1.1 Definicioni i aftësisë së kufizuar sipas legjislacionit të Kosovës dhe konventës ndërkombëtare

Neni 1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) jep këtë definicion për personat me aftësi të kufizuara:

***“Personat me Aftësi të Kufizuara përfshijnë individët me dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale apo shqisore të cilat në ndërveprim me barrierat e ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri nëse si pjesa tjetër e shoqërisë.”*¹**

Termi persona me aftësi të kufizuara përdoret në Kushtetutën e Kosovës, dhe

theksohet në parimet e barazisë dhe diskriminimit.

Legjislacioni në fuqi në Kosovë jep këtë definicion: “*Aftësia e kufizuar*” është kufizimi i qasjes dhe kufizim i aktiviteteve të zakonshme në jetën e përditshme të një personi, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore ose mendore, që e pengojnë atë për pjesëmarrje në aktivitetet e zakonshme ditore.”²

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006) është e shkruar në 6 gjuhë (anglisht, frëngjisht, rusisht, arabisht, kinezisht dhe spanjollisht), ndërsa përkthimet në gjuhët e tjera duhet ta përdorin termin që është i pranueshëm nga vetë komuniteti i personave me aftësi të kufizuara. Përkthimi në gjuhën shqipe është bërë

¹Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2006, faqe 5.

²Ligji Nr. 03/L-019 i Republikës së Kosovës për aftësimin, riaftësimin profesional, dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, 2009, faqe 1.

nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, dhe me këtë përkthim Konventa është e publikuar në ueb faqen e OKB-së.

Çfarëdo terminologjie tjetër për aftësi të kufizuara dhe persona me aftësi të kufizuara nuk është e pranueshme për personat me aftësi të kufizuara dhe as për organizatat që i përfaqësojnë ata/ato.

1.2 Modelet e qasjeve që u referohen aftësisë së kufizuar

Ka qasje të ndryshme të cilat pasqyrojnë qëndrimet e shoqërisë për personat me aftësi të kufizuar, dhe në disa raste më shumë se një model mund të përdoret në të njëjtën kohë. Më poshtë janë të paraqitura disa përshkrime të shkurtra

për modelet e ndryshme që mund të gjinden në shoqëri, të bazuara në publikimin “Qasje e barabartë: Si të përfshijmë personat me aftësi të kufizuar në procese zgjedhore dhe politike”³:

✗ **Modeli i bamirësisë** – kur besohet që personat me aftësi të kufizuara vazhdimisht kërkojnë ndihmë dhe nuk janë të aftë për tu bërë pjesëmarrës të plotë në shoqëri. Në kuadër të këtij modeli, ata/ato shikohen me keqardhje.

✗ **Modeli mjekësor** – kur personat me aftësi të kufizuara trajtohen sikurse aftësia e tyre e kufizuar është shkak i çdo barriere. Në këtë model, personat me aftësi të kufizuara inkurajohen që t'i përshtaten barrierave dhe ambientit, në vend që të punohet drejt qasjes së përgjithshme.

✗ **Modeli social** – kur aftësia e kufizuar definohet si pasojë e ndërveprimit të

³ “Qasje e barabartë: Si të përfshijmë personat me aftësi të kufizuar në procese zgjedhore dhe politike”, Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore dhe Instituti Demokratik Kombëtar, 2014, faqe 25.

personit me ambientin e tij/saj. Preambula e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara thekson se “aftësia e kufizuar vjen nga ndërveprimi në mes personave me dëmtime dhe barrierave të qëndrimeve shoqërore dhe ambientit, të cilat e pengojnë pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri në suaza të barabarta me të gjithë.”⁴

✓ **Modeli i bazuar në të drejta** – këtu, theksi bie nga varësia te fuqizimi. Personat me aftësi të kufizuara i kanë të drejtat bazike njerëzore të njëjta si të gjithë qytetarët dhe qeveria duhet t’ua garantojë këto të drejta, si dhe duhet të jetë përgjegjëse për mbrojtjen e tyre.

Përderisa të gjitha këto modele mund të gjinden në shoqëri, modeli i bazuar në të drejta është modeli i vetëm i pranueshëm nga personat me aftësi të kufizuar, pasi që ky model trajton personat me aftësi të kufizuar si gjithë individët tjerë në shoqëri.

⁴Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Preambula (e)

2 TERMINOLOGJIA DHE FJALËFORMIMI I DUHUR GJATË REFERIMIT DHE KOMUNIKIMIT ME PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

2.1 Njohuri të përgjithshme dhe fjalëformimi i duhur gjatë referimit dhe komunikimit me persona me aftësi të kufizuara

Personat me aftësi të kufizuara përfaqësojnë rreth 15% të popullsisë botërore sot.⁵ Sidoqoftë, edhe pse ky numër është i madh, është shumë pak i përfaqësuar në media. Për më tepër, si pasojë e mungesës së informatave të duhura apo në disa raste mentalitetit, personat me aftësi të kufizuara referohen shumë shpesh me terme të papranueshme, që shpesh mund të jenë ofenduese. Ky trend përcillet edhe në Kosovë.

Shumica e shteteve që kanë traditë në demokraci përveç legjislacionit të zbatueshëm kundër diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, kanë edhe kode të veçanta etike të cilat zbatohen nga mediat. Një kod i tillë etik do të fuqizonte mbrojtjen shtetërore të personave me aftësi të kufizuara si dhe do të stimulonte mirëkuptim shoqëror në Kosovë. Sidoqoftë në mungesë të një kodi të këtillë, ky doracak, i përpunuar në bashkëpunim me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, do të shërbejë si udhëzues për përdorimin e terminologjisë së duhur për personat me aftësi të kufizuar. Në vijim janë disa rregulla dhe parime të përgjithshme, të bazuara në publikimin “Rregullat e Mirësjelljes për Personat me Aftësi të Kufizuara”⁶ dhe në konsultime me organizata të personave me aftësi të kufizuar në

⁵ “Raporti i Botës për Aftësinë e Kufizuar”, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2011, faqe 29.
⁶ “Rregullat e Mirësjelljes për Personat me Aftësi të Kufizuara”, Shoqata e Bashkuar për Kurriz (United Spinal Association), 2009.

Kosovë, të cilat duhet të aplikohen gjatë fjalëformimit.

○ Parimi kryesor që duhet të përcillet kur l referohemi personave me aftësi të kufizuara është që ata/ato gëzojnë të drejta si çdokush. Kjo nënkupton që ata/ato nuk dëshirojnë të trajtohen apo cilësohen si “të veçantë”. Aftësia e kufizuar nuk e definon personin, këtë e bën personaliteti dhe vlerat e tij/saj. Nëse theksi bie në aftësitë e kufizuara, krijohet “veçantia” e cila si e tillë krijon pabarazi në shoqëri dhe i vë në pozita “speciale” personat me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara duhet të referohen si persona me të drejta të plota, e jo të veçanta. Nuk duhet asnjëherë të përdoren shprehje të cilat krijojnë dallime.

○ Parimi tjetër që duhet të përcillet është se aftësia e kufizuar është personale dhe si e tillë, mund të përmendet, apo të shtjellohet vetëm me pëlqimin e personit me aftësi të kufizuar. Kur referohet një

person me aftësi të kufizuar, termi duhet të jetë i përgjithshëm dhe i pranueshëm nga ai/ajo. Termi i përgjithshëm i pranuar është Person me aftësi të kufizuar. Termet si “hendikep”, “paralitik”, “invalid”, “me nevoja të veçanta”, apo “i vonë” duhen të shmangen. Për çfarëdo reference e vetmja shprehje e pranueshme është “aftësi e kufizuar”.

○ Nëse duhet t’i referohemi aftësisë së kufizuar të një personi, përdoreni gjuhën që e vë individin para aftësisë së kufizuar. Për shembull mund të thuhet “Person me aftësi të kufizuar fizike” apo “Person me Sindromin Down.” Mos e vëni theksin në aftësinë e kufizuar gjatë fjalëformimit.

○ Më tutje, duhet treguar kujdes me shprehjet që lidhin individin me aftësinë e kufizuar. Për shembull lidhëza “me” është e pranueshme apo “i/e” në raste si “Person me aftësi të kufizuar” apo “Person i verbër”. Nuk duhet të

përdoren terme si “vuan nga”, “viktimë e”, “i sëmurë me” dhe “i kufizuar nga”. Këto terme i vëjnë nuancë negative dhe ofenduese aftësisë së kufizuar dhe si të tilla duhet të shmangen. Në disa raste termi “i/e prekur nga” mund të përdoret, por në shumicën e rasteve është zëvendësuar.

○ Termi “Person me nevojë të veçantë” nuk nënkupton domosdoshmërisht personin me aftësi të kufizuar. Nevoja e veçantë cilësohet ajo rrethanë, ku një personit i nevojiten mjete apo ndihmë për të arritur një qëllim të caktuar. Pjesë e nevojave të tilla mund të jenë : fëmijët me vështirësi në mësim, personat e moshuar, personat që kanë pësuar lëndime etj. Aftësia e kufizuar është diçka e përhershme ose afatgjatë, e cila mund të sjell rrethana për nevoja të veçanta, mirëpo nuk lidhet domosdoshmërisht me të. Prandaj duhet të mos ngatërrohet shprehja “Persona me nevoja të veçanta” me personat me aftësi të kufizuar.

○ Personat me aftësi të kufizuara nuk duhet të kategorizohen si një grup i veçantë. Referimet duhet të jenë individuale apo për grupe të caktuara (nëse është e pranueshme për ata/ato të përcaktohen si grup i tillë). Aftësitë e kufizuara poashtu nuk duhet të kategorizohen si një grup i veçantë. Çdo aftësi e kufizuar është individuale, dhe një person mund të ketë një apo më shumë aftësi të kufizuara. Sidoqoftë, nuk duhet të supozohet që një aftësi e kufizuar përfshinë në vete ndonjë aftësi tjetër të kufizuar.





○ Grupi për Qasje në Zgjedhje
○ Grupa za Pristup Izborima.
○ Election Access Group

2.2 Terminologjia e duhur për aftësitë e kufizuara

Kur i referohemi personave me aftësi të kufizuara duhet të përdoren terme të përgjithshme. Termi “person me aftësi të kufizuar” dhe “aftësi e kufizuar” janë të pranueshëm për të gjitha llojet e aftësive të kufizuara. Sidoqoftë, nëse duhet të elaborohet më hollësisht aftësia e kufizuar, atëherë duhet të përdoren terme të përgjithshme për aftësi të kufizuara specifike. Lista në vijim pasqyron një përmbledhje të disa aftësive të kufizuara, dhe mënyrën se si duhet t’i referohemi atyre në media:

**Termi i përgjithshëm
i duhur**

Person me aftësi të kufizuar

**Termet e përgjithshme
të gabuara**

Person me nevoja të veçanta/ të
posaçme
Person me të meta
Invalid
Hendikep

Termet specifike të duhura

**I/E Verbër
Person me dëmtim në të parë**

**I/E Shurdhër
Person gjysmë i/e shurdhër**

Trupshkurtër

Termet specifike të gabuara

Qorr
Gaman

Shurdh-memec
Shurdhan

Shkurtabiq
Xhuxh

Termet specifike të duhura

Person me aftësi të kufizuara fizike

Person i prekur me Sindromin Down

Person me Autizëm

Person me aftësi të kufizuar intelektuale

Person me aftësi të kufizuar psikosociale

Termet specifike të gabuara

I/E paralizuar / paralizik
Sakat
Hendikep
Invalid
Gungaç
Gjytyrym
Tapall

Mongoloid
Me ngecje mendore

Person me sëmundjen e Autizmit
Person i pazhvilluar mentalisht

I/E çmendur
I/E vonshëm/vonshme
Budalla
Idiot
Retard
Me ngecje mendore
Hajvan

Skizofren
Psikopat
I/E çmendur

3 PARAGJYKIMET PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

3.1 Paragjykimet e shpeshta ndaj personave me aftësi të kufizuara

Ekzistojnë shumë paragjykime të cilat shpesh shkaktohen nga frika, apo mungesa e informatave dhe ndonjëherë nga mentaliteti i vjetërsuar mbi personat me aftësi të kufizuara. Promovimi i këtyre imazheve negative mbi aftësitë e kufizuara është formë e diskriminimit, dhe si i tillë krijon barriera për personat me aftësi të kufizuara për pjesëmarrje të plotë në jetën qytetare. Paragrafët në vijim janë të bazuar në publikimin “Mitet dhe idetë e gabuara për aftësinë e kufizuar”⁷, dhe përmbledhin disa nga paragjykimet dhe stereotipet më të shpeshta që dalin në shoqëri.

Është e rëndësishme që këto paragjykime të shmangen gjatë referimit dhe komunikimit me persona me aftësi të kufizuara.

Paragjykimi #1: Aftësia e kufizuar e një personi e definojnë atë si individ

Personat me aftësi të kufizuara shpesh kategorizohen në bazë të gjendjes së tyre, dhe në disa raste mund të dëgjohen referenca si “ata me aftësi të kufizuara”. Grupimi dhe emërimi në bazë të gjendjes së individëve me aftësi të kufizuara vetëm i stigmatizon ata/ato si dhe krijon paragjykime ofenduese. Personat me aftësi të kufizuar, si gjithë personat tjerë, definojnë në bazë të vlerave personale dhe shkathtësive të ndryshme, jo aftësisë së kufizuar.

⁷ “Mitet dhe idetë e gabuara për aftësinë e kufizuar” Organizata Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara- Së bashku jemi më të fortë!

Paragjykimi #2: Personat me aftësi të kufizuara janë të sëmurë dhe kanë gjithmonë dhimbje

Personat me aftësi të kufizuara, si të gjithë, mund të sëmuren apo të kenë dhimbje ndonjëherë. Sidoqoftë, në shumicën e rasteve, personat me aftësi të kufizuara nuk kanë dhimbje nga aftësia e tyre e kufizuar.

Paragjykimi #3: Personat me aftësi të kufizuara janë të veçantë dhe duhet të trajtohen ndryshe

Kategorizimi i një personi me aftësi të kufizuar si i/e “veçantë” është në kundërshtim me parimet e barazisë, pasi që me këtë emërtim nënvlerësohet edhe pritshmëria e suksesit të tyre. Personat me aftësi të kufizuara gëzojnë të drejta të barabarta dhe janë pjesë e barabartë e shoqërisë, jo të veçantë me të drejta të veçanta.

Paragjykimi #4: Personat me aftësi të kufizuara janë gjithmonë të varur nga dikush dhe u nevojitet ndihmë gjithmonë

Si çdokush, edhe personat me aftësi të kufizuara mund të kenë ndonjëherë vështirësi dhe nevojë për ndihmë; sidoqoftë, kjo nuk nënkupton që ata/ato domosdoshmërisht varen nga kjo ndihmë. Gjithmonë pyesni nëse mendoni se dikush mund të ketë nevojë për ndihmë, por mos supozoni që ata kanë nevojë për ndihmë vetëm pse kanë aftësi të kufizuara.

Paragjykimi #5: Personat me aftësi të kufizuara janë gjynah/për të ardhur keq

Aftësia e kufizuar shpesh shihet si tragjedi, dhe rrjedhimisht personat me aftësi të kufizuara në shumë raste trajtohen me keqardhje për gjendjen e tyre. Në fakt, aftësia e kufizuar është vetëm një dimenzion i jetës së personave

me aftësi të kufizuar, pasi që ata/ato kanë shkathësi dhe vlera me të cilat kanë po aq mundësi të arrijnë sukses dhe të jetojnë një jetë të plotë, si të gjithë të tjerët.

Paragjykimi #6: Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e një grupi një-dimensional

Në shumicën e rasteve personat me aftësi të kufizuar trajtohen si pjesë e një grupi, ku të gjithë kanë të njetat mendime dhe interesa vetëm pse kanë aftësi të kufizuar. Edhe në komunitetin e personave me aftësi të kufizuara ka shumë mendime të ndryshme për çështje të ndryshme, si në gjithë shoqërinë.

Paragjykimi #7: Personat me aftësi të kufizuara shoqërohen vetëm me njëri tjetrin.

Shpesh në shoqëri është një përshtypje se personat me aftësi të kufizuara dëshirojnë të shoqërohen vetëm me

persona tjerë me aftësi të kufizuara. Në fakt, si gjithë tjerët, edhe personat me aftësi të kufizuara zgjedhin shoqëritë e tyre në bazë të vlerave dhe interesave të përbashkëta.

Paragjykimi #8: Personat me aftësi të kufizuara nuk mund të bëjnë jetë produktive.

Personat me aftësi të kufizuara janë më se të aftë të marrin pjesë në jetën në komunitet. Ata/ato shkollohen, punojnë, kanë hobi, krijojnë familje, si të gjithë tjerët. Sfida është të vihet fokusi në shkathësitë e një individi e jo e kundërta.

3.2 Paragjykimet mbi personat me aftësi të kufizuara në shoqërinë kosovare

Në shoqërinë kosovare ekziston një trend mjaft negativ ndaj qasjes drejt personave me aftësi të kufizuara. Për shkak të mungesës së informatave dhe perceptimeve të gabuara në Kosovë ka shumë paragjykime diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara. Këto paragjykime në mungesë të trajtimit krijojnë bindje të gabuara, stimulojnë jo barazi dhe stigmatizojnë personat me aftësi të kufizuara.

Në vijim janë të shënuara disa paragjykime që dalin shpesh në shoqërinë kosovare, dhe të cilat duhet të shmangen. Këto paragjykime janë identifikuar nga organizata të personave me aftësi të kufizuar.

Paragjykimi #1: Personat me aftësi të kufizuara kanë gjendje të rëndë ekonomike dhe kërkojnë lëmshë

Gjendja ekonomike e personave me aftësi të kufizuara nuk lidhet domosdoshmërisht me aftësinë e kufizuar. Personat me aftësi të kufizuara punojnë sipas mundësive dhe kontribuojnë pozitivisht në shoqëri. Është shumë fyese t'i ofrohet lëmshë një personi me aftësi të kufizuar i/e cili/cila nuk kërkon lëmshë.

Paragjykimi #2: Personat me aftësi të kufizuara mund ta bartin aftësinë e kufizuar tek të tjerët

Në Kosovë ende ekzistojnë disa ide fyese dhe të papranueshme për personat me aftësi të kufizuara. Në jetën e përditshme në Kosovë, shpesh personat me aftësi të kufizuara shmangen për shkak të frikës së pabazë se aftësia e tyre e kufizuar mund të bartet. Aftësia e kufizuar nuk mund të bartet, për dallim nga paragjykimet e gabuara.

Paragjykimi #3: Personat me aftësi të kufizuara nuk janë të aftë të komunikojnë vet, prandaj komunikimi duhet të bëhet me asistentin/asistenten e tyre

Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë integrale e shoqërisë dhe janë të aftë të komunikojnë. Aftësia e kufizuar nuk e kufizon aftësinë e komunikimit në shumicën e rasteve. Mos flisni me asistentin/asistenten e personit me

aftësi të kufizuar por drejtohuni vetë individit. Nëse personi me aftësi të kufizuar ka problem me komunikim, këtë do ta kumtojë vetë ai/ajo apo personi që e ndihmon.

Komunikimi mund të jetë sfidë kur bëhet fjalë për komunitetin e shurdhër, të cilët përdorin gjuhën e shenjave kosovare si gjuhë amëtare. Kjo njihet edhe me shkurtesën GjShK. Gjuha e shenjave ka gramatikën e saj dhe të gjitha rregullat e predikimit, dhe mund të mësohet nga kushdo që është i/e interesuar. Gjuha e shenjave njihet edhe nga KDKAK, Neni 2, [*“Gjuha” përfshin gjuhën e folur dhe gjuhën e shenjave si dhe forma të tjera të gjuhës jo-të-folur.*]⁸ Gjuha e shenjave në Republikën e Kosovës është zyrtarizuar në vitin 2010.

⁸Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me aftësi të Kufizuar, Neni 2.

Disa fakte rreth gjuhës së shenjave:

Mitet	Faktet
<p>Gjuha e shenjave është renditje piktoreske e fjalëve të folura në formë të shkurtuar.</p> <p>Konceptet abstrakte nuk mund të shprehen në gjuhën e shenjave.</p>	<p>Gjuhët e shenjave kanë rregulla komplekse gramatikore dhe fjalor shumë të pasur dhe janë të përshtatshme në zbërthimin e bisedave intelektuale, retorike, humorit dhe poezisë.</p>
<p>Gjuhët e shenjave janë universale, të njëjta në të gjithë botën.</p>	<p>Gjuhët e shenjave janë të ndryshme sikurse edhe gjuhët e folura si dhe shkencërisht është vërtetuar se në secilin shtet gjuha e shenjave ka edhe dialektet e tyre, ashtu siç kanë edhe gjuhët e folura.</p>

Paragjykimi #4: Personat me aftësitë kufizuara janë të rrezikshëm për shoqërinë

Rrezikshmëria e një individi nuk përcaktohet nga aftësia e kufizuar e tij/saj. Qëndrimet e gabuara të shoqërisë se personat me aftësi të kufizuara nuk janë të aftë t'i qasen shoqërisë dhe mund të jenë të rrezikshëm, njollosin këta persona si dhe bartin ide të gabuara - të cilat më tutje krijojnë mentalitetin e gabuar dhe ofendues në shoqëri.



PËRMBYLLJE

GQZ ka përpiluar këtë udhëzues për sensibilizimin e mediave me terminologjinë dhe njohuritë e duhura për referimin e personave me aftësi të kufizuara. Terminologjia e duhur është përcaktuar në bashkëpunim me organizatat kosovare që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara, dhe kështu reflekton qasjen sociale mbi aftësitë e kufizuara. Udhëzuesi do të shërbejë si referencë për definicionet bazike, qasjet shoqërore, fjalëformimin e duhur dhe terminologjinë mbi aftësitë e kufizuara. Duke konsideruar që mediat dhe hisedarë të tjerë janë burim dhe bartës të rëndësishëm të informatave tek publiku i gjerë, është e rëndësishme që ato ta zbatojnë këtë udhëzues për t'iu referuar aftësive të kufizuara në mënyrën e duhur, dhe në këtë mënyrë t'i sensibilizojnë dhe në formë indirekte edukojnë qytetarët mbi këtë çështje të rëndësishme.

REFERENCAT

“Mitet dhe idetë e gabuara për aftësinë e kufizuar” Organizata Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar- Së bashku jemi më të fortë!

“Qasje e barabartë:Si të përfshijmë personat me aftësi të kufizuar në procese zgjedhore dhe politike”, Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore dhe Instituti Demokratik Kombëtar, 2014.

http://www.ifes.org/sites/default/files/equal_access_how_to_include_persons_with_disabilities_in_elections_and_political_processes_2.pdf

“Raporti i Botës për Aftësinë e Kufizuar”, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2011. http://www.who.int/disabilities/world_report/2011/en/

“Rregullat e Mirësjelljes për Personat me Aftësi të Kufizuara”, Shoqata e Bashkuar për Korriz (United Spinal Association), 2009

<https://www.unitedspinal.org/pdf/DisabilityEtiquette.pdf>

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, 2006.

http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf

Ligji Nr. 03/L-019 i Republikës së Kosovës për aftësimin, riaftësimin profesional, dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, 2009.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2620>





USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

